



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

V E N D I M

Nr. 234, Datë 29.12.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është paraqitur ankesa nr. 190, datë 05.12.2022, e shtetases E.S.kundër Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. E.V. në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore” (e divorcuar), “gjendjes familjare” (e divorcuar), “gjendjes martesore” (e divorcuar), “gjendjes civile” (e divorcuar) dhe “aftësisë së kufizuar të djalit të saj D.S.”.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Prej pesë vitesh, i kam kërkuar në vijimësi z. E.V., të më gjendet punësim, strehim dhe nuk më është kthyer asnjë përgjigje, si dhe nuk i është dhënë zgjidhje problematikave që lidhen me to. Sqaroj se nuk kam aplikuar për një nga programet e strehimit. Kam kërkuar pranë zyrës së punës të më gjendet një vend pune, por nuk më shtë ofruar asnjë. Për sa më lart ndihem e diskriminuar për shkak se jam e divorcuar, për shkak se kam një djalë me aftësi të kufizuara dhe jam në gjendje të rënduar ekonomike³, pasi jetoj me të ardhurat nga pagesa e invaliditetit të djalit D.S.”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar Vërtetimit nr. 101/1, datë 17.11.2020 të lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. 3, Tiranë, vërtetohet se shtetasi D.S trajtohet me pagesë të aftësisë ndryshe në masën 10845 lekë/muaj, me kujdestar znj. E.S.me masën e përfitimit mujor 10845 lekë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së dhe parashtrimeve të saj, Komisioneri konstatoi se:

1. Lidhur me pretendimin për moskthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të saj nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Subjekti ankues është shprehur se ka paraqitur disa kërkesa⁴ pranë Kryetarit të Bashkisë Tiranë në të cilat ka kërkuar punësim dhe strehim, nga ana e tij. Pretendimi i ankueses lidhet me refuzimin e

⁴ Referuar dëftësave për pranimin e objekteve postare datë: 09.02.2021 dhe 22.03.2022.

Kryetarit të Bashkisë, për t'iu përgjigjur zyrtarisht kërkesës së saj apo për ta njohur atë me arsyet e refuzimit.

Komisioneri vëren se, mosveprimi institucional i Kryetarit të Bashkisë Tiranë ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

KMD vlerëson se lidhur me pretendimin e ankueses, se Kryetari i Bashkisë Tiranë nuk i është përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

Mbështetur në nenin 24⁵, të këtij ligji, KDIMDHP, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të shtetasës E.S.për moskthim përgjigje nga ana e Kryetarit të Bashkisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁶.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

⁵ “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, KDIMDHP ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'iu kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. KDIMDHP merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se KDIMDHP nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

⁶ Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

2. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim të saj nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, duke mos i ofruar mundësi për strehim.

Lidhur me pretendimin se është diskriminuar nga Kryetarit të Bashkisë Tiranë, pasi nuk i ka ofruar mundësi punësimi dhe strehimi, ankuesja ka dërguar kopje të shkresave të saj, në të cilat ka përshkruar situatën e përgjithshme të gjendjes së saj familjare dhe në mes të tjerash ka kërkuar nga Kryebashkiaku që t'i sigurohet punësim dhe strehim.

Lidhur me çështjen e strehimit, legjislacioni shqiptar ka rregulluar ligjërisht çështjen e mbështetjes dhe krijimit të mundësive për strehim të familjeve që janë në nevojë. Në këtë kontekst, ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social" ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Sipas nenit 3/3 të ligjit të sipërcituar, strehimi i familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërit prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.

Ligji i sipërcituar përcakton edhe llojin e programeve sociale të strehimit. Sipas nenit 11 të këtij ligji, përcaktohet se:

"1. Në programet sociale të strehimit përfshihen:

a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;

b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;

c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;

ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;

d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;

dh) programi i banesave të specializuara.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.

3. Individit/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë."

Në referencë të nenit 13 të ligjit të sipërcituar, statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave; b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat: i) i fatkeqësive natyrore; ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë; iii) i

zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve; iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë; c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj. Parashikimet e sipërcituara, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

Në nenin 14, pikat 1-2, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” parashikohet se:

“1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit.
2. Individu/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.”

Për sa më sipër, znj. Sollaku ka deklaruar shprehimisht se nuk ka aplikuar për asnjë program strehimi që zbatohet nga Bashkia Tiranë. Në këto kushte, ankuesja pretendon për shkeljen e të drejtës për strehim, ndërkohë që nuk ka aplikuar asnjehërë sipas dispozitave ligjore në programet e strehimit të Bashkisë Tiranë. Në nenin 33, pika 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.....”*. Në këtë kontekst, KMD gjykon se pretendimi i ankueses nuk mund të pranohet për shqyrtim, pasi është haptazi i pabazuar.

Për sa më sipër, Komisioneri rekomandon që bazuar në nenin 14 të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”, znj. E.S. duhet të aplikojë në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit, që të përfitojë nga programet sociale të strehimit.

3. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim të saj nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, duke mos i ofruar mundësi për punësim.

Në kërkesat e znj. Sollaku drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë është kërkuar gjithashtu edhe mundësia për t’u punësuar. Në bazë të nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar parashikon se:

“Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;*
- b) zbaton aktet e këshillit;*
- c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;*
- ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësisë administrative*

përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;

d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;

dh) është anëtar i këshillit të qarkut;

e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;

ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;

f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;

g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat të bashkisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;

j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;

l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.”

Sikurse vihet re nga sa më sipër, Kryetari i Bashkisë ka tagër punësimin e disa kategorive të caktuara punonjësish, për pozicione të caktuara pune, ku marrëdhënia e punësimit rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, të tilla si: zëvendëskryetarët e bashkisë, administratorët e njësive administrative/lagjeve, anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi, nëpunësit vendorë për barazinë gjinore, apo punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil.

Për sa më sipër, KMD ka konstatuar se kërkesat e ankueses drejtuar z. E.V., Kryetar i Bashkisë Tiranë, ku kërkohet punësim, nuk i janë referuar një pozicioni konkret të shpallur vakant në aparatet e brendshëm të Bashkisë Tiranë, apo në institucionet e varësisë së këtij institucioni, ku arsimi, kualifikimet dhe eksperiencia në punë e ankueses të jenë të përshtatshme me vendin e punës, në mënyrë që ajo t’i nënshtrohet konkurrimit sipas legjislacionit në fuqi, sikurse të gjithë kandidatët e tjerë. Procedura e rekrutimit të punonjësve në Bashkinë Tiranë ndjek parashikimet e

dispozitave përkatëse të Kodit të Punës, lidhur me emërimet që kryen Kryetari i Bashkisë dhe parashikimet e legjislacionit për nëpunësin civil, në rastet kur pozicioni i punës bën pjesë në shërbimin civil.

Për sa më sipër, KMD i sugjeron ankueses që nëse kërkon punësim brenda strukturave të Bashkisë Tiranë apo atyre në varësi të këtij institucioni, të marrë informacion mbi pozicionet vakante të shpallura nga ky institucion, të verifikojë përshtatshmërinë e kriterëve të pozicionit të punës me arsimin, kualifikimet dhe vjetërsinë e saj në punë, si dhe të aplikojë rregullisht sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 33, pika 4/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.....”*.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se pretendimi i ankueses nuk mund të pranohet për shqyrtim, pasi është haptazi i pabazuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronjat “b” dhe “ç”, të LMD-së, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

- Lidhur me kërkesën për punësim të ankueses, Komisioneri rekomandon që bazuar në nenin 4/1 dhe 13 të ligjit 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, znj. E.S. duhet të regjistrohet si punëkërkuese pranë Agjensisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Tiranë, që të përfitojë nga programet e punësimit.

Sipas pikës 13 të nenit 3, të ligjit të sipërcituar, *“punëkërkues”* është çdo person me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në moshë pune, që regjistrohet si kërkues pune në strukturën rajonale/vendore dhe është i gatshëm për punë.

Pikërisht vetëm pas kryerjes së këtij regjistrimi, strukturës përgjegjëse i lind detyrimi ligjor për t’i siguruar punë personit të regjistruar, fakt që është i parashikuar në nenin 4, pika 1 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, ku përcaktohet se: *“Çdo punëkërkues dhe punëdhënës i regjistruar në strukturën rajonale/vendore përfiton nga shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë.”*

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, pika 4, gërma “b” dhe “ç”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 190, datë 05.12.2022 së znj. E.S. kundër Kryetarit të Bashkisë Tiranë, pasi nuk plotëson kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha- Shërbime

Shkak - “gjendja ekonomike”, “gjendja shoqërore”, “gjendja familjare”, “gjendja martesore”, “gjendjes civile” dhe “aftësisë së kufizuar të djalit të saj D.S.”.

Lloji i vendimit - mospranim